

## AKT-THEMELIMI

### I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA

#### “SAMEGA” SH.P.K.

#### I nënshkruari:

##### Ortaku i vetëm:

- Z. JON GJON-BOÇARI**, lindur në Tiranë, më 16.02.1994, madhor e me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i pajisur me pasaporte Nr. BG0093652, numer personal J40216056V, banues në adresën: Rruga “Sulejman Pitarka”, Nr. 5, Nd. 20, H. 5, Ap. 16, Tiranë, sot, më datë 09.09.2022:

*në cilësinë e “Ortakut të vetëm Themelues”, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, në ligjin 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, në Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijoj shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, me emërtimin “SAMEGA” sh.p.k.*

#### Neni 1

1.1 Të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar për të ushtruar veprimtarinë sipas përcaktimeve të statutit të saj, e emërtuar “SAMEGA” sh.p.k.

#### Neni 2

2.1 Shoqëria do të jetë e formës së Shoqërive Tregtare me Përgjegjësi Të Kufizuar (SH.P.K.) dhe përballon humbjet sipas ligjeve në fuqi.

#### Neni 3

3.1 Shoqëria e ka selinë e saj në Tiranë, me adresë: Rruga “Ylberë Bylykbashi”, Pallati 23, Shk. 2, Ap. 6.

3.2 Shoqëria mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë si edhe jashtë saj si dhe ti suprimojë ato.

#### Neni 4

4.1 Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje me kufi të pacaktuar, ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë me vendim të ortakëve sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar.

## **Neni 5**

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 10.000 (dhjetë mijë) lekë.

5.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 (një) pjesë me vlerë nominale 10.000 (dhjetë mijë) lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përpushje me kontributet e tyre si më poshtë:

1. Ortaku i vetëm Themelues Z. Jon Gjon-Boçari; Zotërues i 1 (një) pjesë, me vlerë të përgjithshme 10.000 lekë që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

5.3 Kontributi i ortakut të vetëm dhe ose i ortakëve, mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/ të paluajtshme, apo të drejta).

## **Neni 6**

6.1 Në librin e llogarisë së shoqërisë do të krijohet “Fondi Themelor i Ortakëve”.

6.2 Rritja e kapitalit të ortakëve nuk është e kufizuar.

## **Neni 7**

7.1 Të gjitha pjesët e kapitalit themelor janë tërësisht të shlyeshme dhe të nënshkrueshme nga secili ortak i shoqërisë.

## **Neni 8**

### **Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:**

Objekti I veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- Ofrimi, organizimi dhe zhvillimi i kurseve të ndryshme për ciklin e ulët, programe pashkollore, parashkollore. Ofrimi i kurseve profesionale online të tipit e-learning, si dhe workshop të çdo lloj fushe. Organizimi dhe zhvillimi i seminareve dhe trajnimeve, të çdo lloj fushe;
- Organizimi dhe zhvillimi i seminareve dhe trajnimeve përgatitore për student, për marrjen e diplomave dhe certifikimeve kombëtare dhe ndërkombëtare të gjuhëve të huaja, si dhe çdo lloj programi arsimor, kulturor, artistik, teknik, dhe çdo fushe tjetër për të arritur këtë qëllim;
- Do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushën e administrimit dhe drejtimit didaktik të institucioneve arsimore parauniversitare të përgjithshme dhe profesionale, në këto fusha për kurse të Gjuheve të huaja. Kurse përgatitore një, tre mujore, 6 mujore dhe një vjeçare, për lëndët e Provimeve të Maturës Shtetërore dhe provimeve të lirimimit të klasave të nënta të shkollës 9 vjeçare;
- Kurse për menaxhim biznesi, finance 5, kontabilitet alfa, kurse për agjent tregtar, specialist të marketingut dhe reklamës, drejtues shitjes dhe marketingut, shites;

- Përkthime;
- Studio regjistrimi muzikor, prodhim muzikor, prodhime artistike, kinematografike, prodhim materialesh audio-vizive;
- Organizimi i eventeve, panairëve, publikime, reklama dhe fushata reklamuese, si dhe organizim tjetër artistik dhe televiziv të çdo forme;
- Konsulencë dhe shërbime financiare, ekonomike, juridike që ka lidhje me biznesin, me aktivitetet të ndryshme tregtare dhe çdo aktivitet tjetër ekonomik ndaj personave fizikë dhe juridik, shoqërive, institucioneve publike, private, vëndase dhe të huaja, Start-up, SME, të çfardo lloji fushë që do të kërkohet. Konsulencë dhe ndërmjetësim në lidhje me shitje të produkteve të ndryshme;
- Agjensi turistike me profil të gjerë dhe pa limitim; Organizim udhëtimesh individuale ose në grupe për shtetas shqiptar dhe të huaj brenda dhe jashtë vendit; Promovimi i turizmit në Shqipëri dhe jashtë saj; Shitje biletash, dhe jo vetëm po edhe organizime turesh turistike brenda dhe jashtë vendit; Organizmi transporti turistik tokësor, me guidë shoqëruese dhe jo vetëm, transport detar, ajror, agroturizëm, trajnime, kurse të ndryshme dhe kualifikime në fushën e turizmit. Organizimi i eventeve në fushën e turizmit dhe përthithjes së turistëve të ndryshëm; Organizimi i seminareve trajnuese dhe informuese për guida dhe/ose operatorë të ndryshëm turistikë të huaj apo shqiptarë; si dhe çdo aktivitet tjetër që lidhet me këtë objekt, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi;
- Në fushën e import-eksportit, prodhimit, tregtimit me shumicë dhe pakicë të të gjitha mallrave ushqimore, pijeve të çdo lloji, industriale, pajisjeve dhe materialeve elektrike, elektronike, elektroshtepiake, farmaceutike, të fushës së ndërtimit, imobiliare, makineri, pajisje dhe materiale mjeksore, bujqesore, për fushën e turizmit, të shëndetësisë, të arsimit dhe telekomunikacionit, parfumerie, kozmetike, bukurie, tekstile dhe shendeti, si dhe produkte të tjera dytësore të kësaj kategorie. Importin, eksportin dhe tregtimin me shumicë apo pakicë të të gjitha llojeve të mjeteve motorike duke përfshirë importin e autoveturave;
- Agjenci imobiliare. Krijim, zhvillim, zyra ndërmjetësimi për pasurite e paluajtshme nëpërmjet nënshkrimit të një kontrate të veçantë Franchising, aktivitet ndërmjetësimi për pasuritë e paluajtshme. Aktivitet në fushën e pasurive të patundshme, të angazhohet në shitjen me shumicë dhe pakicë të çdo lloj pasurie dhe të hap dyqane, degë apo zyra po të jetë e nevojshme për arritjen e qëllimit të shoqërisë. Menaxhim dhe administrim pronash dhe objektesh. Administrimin e bashkëpronësisë në prona dhe ndërtesa. Për dhënien më qira, nën qira të ambienteve të ndryshme. Shërbime që kanë të bëjnë me Shitjen, Blerjen dhe Administrimin e Pasurive të Paluajtshme, të Tokave të të gjitha kategorive, të tokave të ndërtimit rezidencial tregtar dhe industrial e të lidhura me to;
- Krijimin e dyqaneve online E-commerce, B2B, B2C. Tregtimi dhe reklamimi i çfardo lloji produkti online. Transporti dhe lëvrimi i mallrave në adresë. Shpërndarja dhe/ose distribucioni online;
- Agjensi marketingu duke përfshirë pa kushtëzim cdo lloj shërbimi të nevojshëm për arritjen e këtij aktiviteti për klientët;
- Shoqëria do kryej pa kufizim cdo aktivitet tjetër të lejueshëm nga legjislacioni në fuqi edhe pse jo i përmendur në këtë akt.

9.1 Marrëdhëniet e punësimit në shoqëri do të rregullohen nëpërmjet Kontratës së Punësimit që lidhet midis paleve në mbështetje të Ligjit Nr. 7961 datë 12.07.1995 (Kodi i Punës) i ndryshuar, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të tij.

### **Neni 10**

10.1 Shoqëria gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj mund të zmadhojë ose të zvogëlojë kapitalin themelor, në bazë të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, “*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*” i ndryshuar.

### **Neni 11**

11.1 Shoqëria vepron në regjimin e pronës private dhe merr përsiper të drejta dhe detyrime vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortakët themelues mbartin rrezikun e veprimtarisë së shoqërisë vetëm në nivelin e kapitalit themeltar të investuar në shoqëri.

### **Neni 12**

12.1 Mosmarveshjet që mund të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, midis punonjësve të saj, si dhe me të tretët, kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, çështja mbetet në kompetencë të Gjykatës së Rrethi Gjyqësor Tiranë.

### **Neni 13**

13.1 Shoqëria do të ketë vulën e saj ku janë përcaktuar emri dhe inicialet e formës së saj ligjore.

### **Neni 14**

14.1 Pasuria e Shoqërisë mund të sigurohet pranë Shoqërive të Sigurimeve.

### **Neni 15**

15.1 Shoqëria e pushon aktivitetin e saj me mbarimin e afatit të përcaktuar në këtë akt themelimi ose për shkaqe të përligjura që gjykohen të tilla nga ortaket, në çdo moment.

### **Neni 16**

16.1 Organet e shoqërisë “**SAMEGA**” sh.p.k, janë:

16.1.1 Asambleja e ortakëve.

16.1.2 Administratori i shoqërisë.

16.2 Modalitetet e formimit dhe funksionimit të tyre do të përcaktohen në Statutin e Shoqërisë.

16.3 Administrator i shoqërisë është: **JON GJON-BOÇARI**.

16.4 Modalitetet për ndryshimin e Administratorit si dhe kompetencat e tij rregullohen nga Statuti i Shoqërisë dhe Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar”.

16.5 Ky akt themelimi nënshkruhet nga ortaku i vetëm i shoqërisë “SAMEGA” me vullnet të lirë dhe të plotë.

**THEMELUESI I SHOQËRISË**

**“SAMEGA” SH.P.K.**

**JON GJON-BOÇARI**

A handwritten signature in black ink, appearing to be 'JG', with a long horizontal stroke extending to the right.